



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO**  
**KOMUNA E GJAKOVËS**  
**OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA**



Nr. 01-112/02-2161  
Datë 14.02.2024

Kryetari i Komunës së Gjakovës, duke u bazuar në nenin 13 dhe nenin 58 pika (b) të Ligjit numër 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 95 paragrafi 2, nenin 96 paragrafi 3 dhe nenin 103 paragrafi 2 të Ligjit numër 08/L-197 për Zyrtarët Publik, nenin 8 të Ligjit të Punës numër 03/L-212 si dhe nenin 15 të Rregullores (QRK) numër 05/2022 për Procedurat Konkurruese dhe Pranimi për Nëpunësit Administrativ dhe Mbështetës, me datë 14.02.2024 merr këtë:

**V E N D I M**

1. Formohet Komisioni i Pranimit për zhvillimin e procedurës së vlerësimit për pozitat *teknike dhe mbështetëse në Teatër*, sipas konkursit me numër 01-111/01-2145 të datës 14.02.2024.
2. Komisionin e Pranimit nga pika 1 e këtij vendimi e përbëjnë:
  - 2.1. Albulena Bokshi – Kryesuese
  - 2.2. Erblina Batusha – Anëtare
  - 2.3. Kushtrim Saraqini – Anëtarë
3. Komisioni i Pranimit, ka për detyrë dhe përgjegjësi që të bëjë vlerësimin e kandidatëve që i nënshtrohen procedurave të vlerësimit nëpërmjet jetëshkrimit dhe intervistës me gojë, për vlerësimin e njohurive, aftësive dhe cilësive profesionale të kandidatëve. Komisioni pas përfundimit të procedurës së vlerësimit shpërbëhet menjëherë.

**A r s y e t i m**

Duke u bazuar në nenin 13 dhe nenin 58 pika (b) të Ligjit numër 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 95 paragrafi 2, nenin 96 paragrafi 3 dhe nenin 103 paragrafi 2 të Ligjit numër 08/L-197 për Zyrtarët Publik, nenin 8 të Ligjit të Punës numër 03/L-212 si dhe nenin 15 të Rregullores (QRK) numër 05/2022 për Procedurat Konkurruese dhe Pranimi për Nëpunësit Administrativ dhe Mbështetës, me qëllim të respektimit të procedurave ligjore të përcaktuara me ligjet në fuqi lidhur me vlerësimin e kandidatëve që kanë aplikuar në pozitat *teknike dhe mbështetëse në Teatër*, në konkursin me numër 01-111/01-2145 të datës 14.02.2024, u caktua komisioni që të bëjë vlerësimin e njohurive, aftësive dhe cilësive profesionale të kandidatëve.

Bazuar në atë që u tha me lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**Vendimi iu dorëzohet:**

- Komisionit të Pranimit
- Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore
- Arkivit

  
**Ardian Gjini**  
Kryetar i Komunës së Gjakovës